

Të mbrojmë dhe forcojmë bashkërisht të arriturat tona shoqërore!

Ligji për dëbim më 1 tetor 2016

Kush rrezikohet dhe për cilat shkelje

2

Debat mbi një botë tjetër

Forumi Social Botëror, Montreal 2016

3

Tubim tematik e zgjedhor në Shafhauzen

Të drejtat dhe mundësitë e migrantëve

4

Nr. 5 | shtator 2016 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

AHV/AVS+ & votimet tjera federale më 25.09.2016

Duhet votuar PO për AHV/AVS+



Kush ka punuar tërë jetën e tij, duhet që nga pensioni i tij i pleqërisë të mund të bëjë jetë si i ka hije. Mirëpo realiteti duket ndryshe: pensionet e Fondeve Pensionale bien poshtë dhe pensionet e AHV çalojnë duke mbetur edhe më mbrapa pas pagave. Të djathtët e ashpër borgjez duan të rrisin në 67 vjet moshën e pensionit dhe planifikojnë një vjedhje gjigande të radhës. Ne edhe përmes demonstratës së plotfuqishme kundërshtuam këtë.

Pensionet e Fondeve Pensionale ulen. Edhe pse paguhen gjithmonë e më shumë para në kolonën e dytë, pensionet janë më të ulëta. Humbet e pensioneve prej 20% nuk janë të rralla. Ndërsa Pensionet e kolonës së parë shoqërore AHV/AVS çalojnë duke mbetur edhe më mbrapa pas pagave: Qiraja dhe premitë e sigurimeve shëndetësore aktualisht përpijnë 2/3 e pensionit maksimal të AHV/AVS-it. Para 40 viteve ishte vetëm gjysma. Kështu në ardhmen AHV/AVS-it dhe ato të Fondeve Pensionale nuk do të mjaftojnë për një jetesë modeste. Andaj është koha e fundit për përmirësime të pensioneve nga kolona e parë e sigurimeve shoqërore AHV/AVS.

Në vend se të merren seriozisht pensionistët e pensionistët dhe të kujdesen për pensione të qëndrueshme dhe të mira, shumica e së djathtës borgjeze në parlamentin nacional predikojnë përkëqisime të mëtejme. Bashkë me shoqëritë e punëdhënësve atakojnë AHV/AVS-in, kërkojnë shkurtime të pensioneve dhe rritje të moshës së daljes në pension deri në moshën 67, bile edhe deri në 70 vjeçe.

Rruga më e sigurtë dhe me kosto më të lirë, për të baraspeshuar humbjet e Fondeve Pensionale është rritja e pensioneve të AHV/AVS-it për 10%. Pasi sigurimi shoqëror i kolonës së parë AHV/AVS nuk varet nga uljet-ngritjet e tregjeve financiare. Ai nuk është top lojë i interesave për profit të shoqërive e fondeve të sigurimeve. Ai është më i sigurtë. Ai financohet në mënyrë solidarë dhe sigurimi shoqëror i kolonës së parë ka raportin më të mirë çmim-shërbim (kontribut-përfitim).

Stop reduktimit

Nën presion nuk janë vetëm pensionet, por edhe pagat, vendet e punës dhe financat publike, heqja e kursit minimal për Euron nga ana e Bankës Kombëtare të Zvicrës deri më tani ka kushtuar me dhjetëra mijëra vende pune. De-industrializimi paraqet kërcënim. Pos kësaj edhe dumpingu në paga edhe më tej është në rend dite. Edhe përkundër kësaj, punëdhënësit, qeveria federale dhe shumica e djathtë borgjeze në Parlament, refuzojnë të mbrojnë më mirë pagat dhe kushtet e punës. Ndërsa në federatë, kantone e komuna progra-

met kursyese ndjekin njeri tjetrin. Në të njëjtën kohë partitë e djathta borgjeze u shpërndajnë pandërprerë dhurata ndërmarrjeve, aksionarëve dhe të pasurve. Gostinë e paguajmë të gjithë ne. Me taksë e tatime më të larta. Si dhe me reduktim të shërbimeve publike.

PO për AHV/AVS+!

AHV/AVS+ është rruga më e thjeshtë dhe me kosto më të lirë, për t'i dhënë fund masakrës në pensione. Pasi AHV/AVS-i ka raportin më të mirë çmim-shërbim. Dhe është më e sigurt, pasi nuk i nënshtrohet fare rreziqeve të tregjeve financiare. Sindikatat e Bashkuara të Zvicrës (SGB/USS), sindikatat që përbëjnë atë dhe «Aleanca për një AHV/AVS të fortë» janë duke udhëhequr një fushatë shumë energjike. Ata do ta luftojnë fuqishëm provokimin e komisionit federal. Andaj, edhe për këtë arsye më 10 shtator 2016 në Bernë u zhvillua një demonstratë me moton «Kundër reduktimeve të pensioneve, për pensione të mira dhe për AHV të fuqishme. Kundër reduktimit të vendeve të punës dhe dumpingut në paga. Dhe kundër varrosjes së shërbi-

meve publike». Rekomandimet tona votuese për dy propozim-ligjet tjera të 25 shtatorit 2016:

PO ekonomisë së gjelbër

Mënyra e tanishme e ekonomisë qon në mbi shfrytëzimin e resurseve natyrore. Me një PO për ekonominë e gjelbër fitojmë të gjithë ne, ekonomia dhe gjeneratat pas nesh.

JO propozim ligjit të shërbimit (shtetëror) të zbulimit

Ligji i ri i shërbimit të zbulimit donë zgjerim masiv të kompetencave të shërbimit (shtetëror) të zbulimit dhe i hap shtetit nuhatës dhe përgjues dypartë. Në të ardhmen ky shërbim do të fitojë mundësinë pa asnjë dyshim të ndonjë veprë të ndërhyrjeve në sferën private të qytetarëve për të mbikëqyrë jetën dhe komunikimin e tyre. Andaj ne i themi JO këtij propozim ligji!

Editorial



Të dashur lexues

Më 25 shtator 2016 qytetarët/ët me të drejtë vote në Zvicër do të votojnë për tri propozim-ligje të rëndësishme. Që të tri këto propozim-ligje kanë të bëjnë me të gjithë ne, pra edhe me banorët/ët, që nuk kanë pasaportë zvicerane dhe që nuk mund të votojnë. Andaj është edhe më se e rëndësishme që ata të motivojnë koleget/ët me të drejtë vote që të marrin pjesë në votime. AHV+ me rëndësi të veçantë Iniciativa AHV+ është një nismë sindikaliste. Të gjithë pensionistët/ët duhet, nëse aprovet iniciativa, të marrin 10% më shumë pension. Për të gjithë ata që kanë paga të ulëta, për njerëzit që kanë punuar pjesëhmë (dhe kohë pas kohe) dhe kanë pasur ndërprerje në karrierën e tyre profesionale, pra para së gjithash për gratë AHV/AVS (Sigurimi Shoqëror Pensional dhe i Trashëgimtarëve) është shumë i rëndësishëm se sa kolona e dytë e Sigurimit Profesional (Trusti) Pensional (BVG/LPP): Kush ka të ardhura më të ulëta, merr nga AHV/AVS pension më të lartë, se sa nga Trusti Pensional. AHV/AVS është shumë më social se sa Trusti Pensional, pasi njerëzit me të ardhura më të larta paguajnë më shumë se sa marrin; Përdërisa punëmarrësit me paga të ulëta marrin më shumë përfitime se sa që kanë paguar kontribute. AHV/AVS jo vetëm se është më sociale, por është edhe më eficientë se sa Trusti Pensional. Për më shumë para të paguara në Trustin Pensional, shumica nga ne në moshë të shtyrë marrim më pak pension. Ndryshe qëndron puna tek AHV/AVS: Pensionet sipas rregullit në çdo dy vite përshtaten me shtrenjtimin dhe zhvillimet e pagave. Kjo është e mundur pa problem, pasi edhe pagat rriten dhe kështu edhe të hyrat në AHV/AVS. Andaj ngritja e AHV/AVS për 10% është më se e nevojshme

Rita Schiavi

anëtare në udhëheqësin qendrore në Unia

News

Sulmi borgjez mbi ligjin e punës

Komisioni i këshillit federal (WAK) dëshiron të hollonte masive të mbrojtjes së punëmarrësve. Në javët e kaluara ky komision ka pranuar dy mocione. Këto duan të eliminojnë rregullat e vlefshme të ligjit të punës mbi orarin maksimal të punës, mbi pushimet dhe punën të dielave për të gjitha degët e shërbimit ekonomike. Ky vendim është në kundërshtim të plotë me faktin e rritjes së qartë në vendin e punës të stresit, burnoutit dhe sëmundjeve tjera psikosociale. Unia ka kritikuar vendimin dhe do të angazhohet, që këto të refuzohen nga këshilli federal.

Pushim masiv të punëtorëve nga ana e presidentit të punëdhënësve

Kështu e kuptojnë «partneritetin social» dy udhëheqësit e përfaqësuesve të punëdhënësve: Burckhard Compression, koncerni industrial e presidentit të punëdhënësve Valentin Vogt, fiton shumë para – megjithatë paralajmëron largime masive nga puna. Presidenti i bordit administrativ Vogt dhe nënpresidenti Hans Hess (njëherazi President i Swissme) shkatërrojnë 100 vende të punës dhe vendosin që 100 punonjës të punojnë me orar të shkurtuar.

Dhurimi i Unia-s për Mjekët pa kufij

Mjekët pa kufij këtë verë ka vendosur që të mos kërkojnë më para nga shtetet e BE-së. Organizata bamirëse ndërkombëtare e arsyeton vendimin e saj me «Efektet shkatërruese të politikës së ndarjes së detyrueshme që bënë BE karshi njerëzve në ikje», me të cilën konfrontohen përditë bashkëpunëtorët e kësaj organizate bamirëse. Unia ndan këtë mendim, andaj edhe mbështet punën e Mjekëve pa kufij me 20000 franga zvicerane.

Përkeqësime serioze tek Arka Pensionale e Manor-it

Arka Pensionale e Manor-it përkeqëson së tepërmi sigurimin e pensionit të pleqërisë për vitin 2017: ngritja e moshës së daljes në pension, kontribute më të larta të punonjësve të moshës mbi 40 vjeçar dhe eliminimi i pensionit të parakohshëm. Unia kritikon këto përkeqësime, të cilat në një degë me paga të ulëta dhe orar të lartë të punës së kohëpaskohshme që prek veçanërisht shumë gratë.



Gastronomia

Kontratë e re nacionale e Punës për Gastronomi nga 2017

Përfaqësuesit e punëmarrësve dhe punëdhënësve të degës së Gastronomisë kanë aprovuar dhe ratifikuar Kontratën e re vendore Kolektive të Punës (L-GAV). Kontrata e re hyn në fuqi nga 1 janari 2017.

Kontrata e re vendore Kolektive e Punës, L-GAV 2017 është rezultat i bisedimeve dyvjeçare mes organizatave të punëmarrësve Hotel & Gastro Union, Syna, Unia dhe përfaqësuesve të punëdhënësve Swiss Catering Association (SCA), gastroSuisse dhe hotelleriesuisse.

Të mbrohen të arriturat

Kontrata e re vendor Kolektive e Punës siguron të arriturat më të rëndësishme nga e kaluara (pagën minimale, 5 javë pushime vjetore, kontrolle të orarit të punës) dhe bie me veti edhe përmirësime tjera për të punësuarit.

Risit e rëndësishme janë:

- Rritja e pagave minimale
- Fuqizimi i trajnimeve
- Zgjatja e pushimit të etërve deri në 5 ditë
- Përmirësim i kontrolleve

Raporte të qëndrueshme deri më 2020

Kontrata e re vendore Kolektive e Punës vlen për 27000 punëdhënës dhe 200000 punëmarrës. Kontrata e re vlen deri së paku në vitin 2020 dhe kujdeset për siguri dhe raporte të qëndrueshme në ketë degë ekonomie.

Osman Osmani



Përmirësimet e mëtejshme në degën e gastronomisë të nevojshme

Ligji për dëbim hynë në fuqi më 1 tetor 2016

Kush mund të goditet nga kjo dhe për cilat delikte?

Në fillim të vitit 2016 u refuzua iniciativa mbi zbatimin e dëbimit, fatmirësisht! Mirëpo, me këtë dëbim i të huajve nuk është hequr nga rendi i ditës. Pak ditë pas votimeve për iniciativën mbi zbatimin e dëbimit, qeveria federale komunikoi rregullat ligjore për implementimin e dëbimit, e cila fuqizohet nga 1 tetori 2016.

Kush mund të preket nga ky ligj?

Është fakt se secili/a i/e huaj në parim mund të dëbohet. Me këtë rast nuk luan ndonjë rol se cilën leje qëndrimi ka personi i prekur (C, B, G, F, N apo S) ose edhe se a është fjala për qytetare/ë të vendeve të BE-së apo atyre të treta. Kjo domethënë se vetëm personat që posedojnë pasaportë zvicerane në asnjë rast nuk mund të dëbohen.

Veprat e rënda mund të qojnë tek dëbimi

Krimet vijuese mund të qojnë tek dëbimi i të huajve: vrasja me (paramendim) dashje (vrasjet, goditjet vdekjeprurëse) lëndime të rënda trupore, format e rënda të vjedhjes (p.sh. vjedhjet me thyerjet, vjedhjet e përsëritura në bandë), plaçkitjet, mashtrimet profesioniste ose kriminaliteti ekonomik e deliktet e pasurisë, format e rënda të kërcënimit

a të zhvatjes, sulmet (ngacmimet seksuale dhe përdhunimi, martesat e detyruar, zjarrvënësja dhe deliktet vdekjeprurëse që rrezikojnë publikun (shoqërinë).

Edhe deliktet e lehta mund të qojnë në dëbim

Mirëpo kujdes: Krahas krimeve të rënda të lartpërmendura, edhe deliktet tjera mund të qojnë në dëbim, e të cilat jo gjithësesi janë të cekura në këtë listë. Mashtrimi i thjeshtë në fushën e sigurimeve shoqërore (AHV/AVS, IV/AI, Arka e sigurimit të papunësisë, sigurimi aksidental, sigurimi shëndetësor, trusti Pensional), mashtrimi tatimor dhe mashtrimet tjera në të cilat shteti joshet që të ofrojë një përfitim apo vendim të paligjshëm (fjala bie dhënia e një lejeje). Gjithashtu, marrja e paligjshme e përfitimeve nga fusha e sigurimeve shoqërore apo nga ndihmat sociale. Kjo domethënë se, secili/a që mash-

tron një qendër-pagimi apo Arkë me të dhëna a informacion të rremë, për të marrë përfitime në të holla (para), mund të dëbohet.

Shkeljet kundër ligjit për të huajt

Në fushën e ligjit për të huajt (migration) mund të qojnë në dëbim veprimtaritë vijuese: Aktiviteti klandestin (ndihma dikujt që ka paguar për hyrje të paligjshme në Zvicër ose në një vend tjetër) ose sigurimin e një vendi pune dikujt pa leje përkatës të



Dëbimi i dhunshëm është jonjerëzor

punës, madje edhe mashtrimet e autoriteteve për të marrë leje qëndrimi nga fusha e ligjit për të huaj. Angazhimi i fuqisë punëtore, pa leje pune dhe kryerja e punëve në të zezë, është gjithashtu e dënueshme, por nuk do të çojë në dëbim, as të punëdhënësit, as të punonjësit. Së fundit, gjithashtu të gjithë ata që kryejnë vepra të rënda në kundërshtim me ligjin mbi substancat narkotike, mund të dëbohen, gjithashtu edhe tregtimi me to në një shkallë të madhe. Nga ana tjetër, nuk janë të kërcënuar me dëbim veprat e ndryshme në fushën e ligjeve të trafikut rrugor.

Klauzola e rasteve të rënda

Ndjekja penale për një nga veprat penale të numëruara nuk nënkupton domosdoshmërisht dëbimin nga Zvicra. Në çdo rast nevojitet një dënim të plotfuqishëm ligjor dhe nuk duhet të paraqes një rast të rëndë. Të tilla raste mund të jenë për shembull atëherë kur personi i huaj është i lindur tashmë në Zvicër dhe vendi i origjinës në të vërtetë nuk njihet fare.

David Aebly
Rechtstabteilung

Kongresi i rregullt i Unia-s

Solidar në shoqëri, të fortë në ndërmarrje

Nuk është për tu besuar që kanë kaluar katër vite! Kongresi i ardhshëm i Unia-s po troket në derë, ndërsa përgatitjet logjistike dhe përmbajtësore janë duke u bërë gjithandëj. Edhe GI (grupi i interesit) i Migracionit përgatitet për Kongresin e Unia-s, për të bërë që zëri i migrantëve/ëve në Kongres të dëgjohej meritueshëm!

Më 27 tetor 2016 fillon: në Palexpo të Gjenezës takohen rreth 400 delegatë nga të gjitha anët e Zvicrës me sfond të ndryshëm profesional e biografik. Ata të gjithë i bashkon fakti i angazhimit aktiv sindikal në Unia, e të cilët do të bashkë-vendosin për zhvillimet e Organizatës në katër vitet e ardhshme.

Strategjia në plan të parë

Kongresi i rregullt është organi më i lartë i sindikatës sonë. Në Kongres nuk do të definohen vetëm strategjia dhe qëndrimet përmbajtësore, porse do të zgjidhen edhe udhëheqja dhe komiteti qendror e sindikatës Unia.

Në qendër të vëmendjes këtë vit është ideja «Solidar në shoqëri, të fortë në ndërmarrje». Kështu që pika kryesore të rendit të ditës do të jenë strategjia dhe zgjedhjet e brendshme. E tëra do të shoqërohet nga referatet e mysafirëve kombëtar e ndërkombëtarë dhe fjalëve të rastit të aktivistëve.

Shumë punë përgatitore

Si organ i autorizuar i Unia-s me të drejtë aplikimi e kërkesash, GI i migracionit, e me këtë edhe anëtarët/et migrant/e të Unia-s, kanë gjithashtu vendin e tyre në Kongres. Për këtë GI migracionit ka kryer punët përgatitore, të cilat ende nuk kanë përfunduar

tërësisht. Në një takim përgatitës dhe në Konferencën e migracionit, GI i Migracionit ka përgatitur aplikimet e kërkesat e saja. Përmbajtja e tyre ka të bëjë me ankorimin më të mirë të migrantëve në strukturat e Unia-s, fuqizimi e punës me migrantë nëpër regjione si dhe synimi i përmirësime materiale për migrantët në politikat

kontraktuese si dhe përparim në njohjen e diplomave.

Mirëpo do të pasojnë edhe kërkesa tjera si rreth temës së personave pa leje (Sans-Papiers), natyralizimi, populizimi i krahut të djathtë dhe shumëçka tjetër! Do të kemi një Kongres intensiv!

Aurora Garcia



Pamje nga puna e komisionit për migracion të Unia-s

Forumi Social Botëror 2016 në Montreal

Debat mbi një botë tjetër

Nga 9 deri më 14 gusht 2016 në Montreal të Kanadasë u mbajt Forumi social botëror (WSF). Edhe Unia ishte me një delegacion pjesë e WSF-së të sivjetmë. 15 vite pas krijimit në Porto Alegre (Brazil) WSF-ja për herë të parë u mbajt në një vend industrial të hemisferës veriore. Programi përbënte tema të mëdha globale dhe ndërkombëtare: Migracioni, Klima, Varfëria, Marrëveshjet për tregti të lirë, mirëpo edhe kërkesa dhe luftëra regionale. Në vijim përshkrimet e një udhëtimi me delegacionin e Unia-

«Migrant Dreams», ëndrrat e migrantëve. Ky është titulli i filmit dokumentar të regjisores kanadeze Min Sook Lee. Filmi pasqyron kushtet e vështira jetësore e migrantëve temporal në Kanada. Statusi i tyre është jashtëzakonisht i pasigurt: lejet e tyre të qëndrimit janë sipas rregullit 8 mujore dhe ato mund të zgjaten deri në katër vjet. Më pas ata nuk mund ti vazhdojnë më tej dhe duhet të lëshojnë vendin duke mos pas të drejtë për katër vite me tjera të kthyer përsëri dhe të punojnë në Kanada. Nëse humbin vendin e punës apo sëmuren duhet gjithashtu ta lëshojnë vendin. Paga e tyre është e ulët varen kryesisht prej ndërmjetësuesve të punës, shpesh edhe për shkak të borxheve, kjo pagë është tejet e lëndueshme.



Marrshi që hap Forumin Social Botëror Montreal 2016

Migrantët dhe imigrantët

Ne në Toronto, pak para Forumit, takuam regjisoren dhe disa nga migrantët që ishin protagonistë në filmin dokumentar. Gjatë bisedës me ta, ne vërejtëm se shprehja «migrant/e» në Kanada nënkupton migrantët me leje të përkohshme (temporale) qëndrimi. Të tjerët, pra shumica e popullsisë janë imigrantët. Shprehjet janë të njëjta, ëndrrat po të njëjta, mirëpo jo të drejtat. «Ky takim, sikur edhe diskutimet tjera në Forumin Social Botëror, më kanë vërtetuar se sa i rëndësishëm është

nada. Një Forum Social Botëror, i cili çka është e vërteta nuk përfaqëson tërë botën...

3 ditë diskutime e shkëmbime

Si gjithmonë programi ishte mjaft i ngjeshur dhe i gjerë. Krahas temave të mëdha globale u trajtuan edhe tema regionale e kontinentale. Mirë të përfaqësuar ishin sindikatat e Kanadasë dhe të tërë botës. U fol për të drejtat e punëmarrësve, të migrantëve, mbi privatizimet, mirëpo edhe për temat ekologjike, teknologjitë e reja... dhe para së gjithash u zhvilluan mjaft takime dhe shkëmbime. «WSF-ja mbetet një rast i mirë për të

mbi migrantët e punës. Barazinë në sektorin e ndërtimitarisë, të drejtat e punëtorëve dhe manifestimet sportive si dhe marrëveshjet për tregti të lirë (TISA, TTIP, CETA). Kjo e fundit ishte mjaft prezent në Montreal, pasi prek edhe vet nikoqirin e WSF-së, Kanadanë. «Marrëveshjet për tregti të lirë janë tema qendrore, pasi ato venë në pikëpyetje të gjitha të arriturat tona sociale e ekologjike dhe ato në rrafshin e Kontratave Kolektive të Punës», vlerëson Rita Schiavi, anëtare e udhëheqjes qendrore në Unia. «WSF-ja arriti të harmonizojë në pika shumë qëndrimet mes sindikatave dhe lëvizjeve tjera sociale».



Pamje nga njëra prej punëtorive të shumta të FSB-së

organizimi i gjithë migrantëve, paravërsisht statusit të tyre» vëren Osman Osmani, sekretar nacional për migracion në Unia.

Mungesa e jugut

Pas dy ditësh ne jemi në Montreal, në mes të marshit e hapjes së WSF-së. Në krye të kolonës marshojnë përfaqësuesit e First Nations dhe Inuits. Lufta e tyre për vendin e të parëve të tyre është tejet prezentë në Forum. Pas tyre ecin sindikatat, organizatat joqeveritare, studentët... Mirëpo dikush mungon. Shumë përfaqësues nga jugu nuk ishin aty, ose për shkak të rrugës së shtrenjtë ose për shkak se nuk iu dhanë vizat hyrëse për në Ka-

shkëmbyer dhe për të lidhë kontakte globale» vjen në përfundim Aurora Garcia, drejtuese e sektorit për migracion në Unia. «Është edhe një rast i mirë, për të reflektuar dhe vërtetuar edhe qëndrimet tona. Unë erdha në përfundim se, fjala bie, puna me të rinjtë në shumë pika është e njëjtë me punën që bëjnë sindikatat tjera» thotë Lena Frank, sekretare nacionale për rini në Unia.

Marrëveshjet për tregtitë lirë

Delegacioni i Unia-s baskë me përfaqësuesit të Sindikatës Ndërkombëtare të Ndërtimitarisë dhe Përpunimit të Drurit ishte e përfshirë në 4 punëtori, të cilat trajtuan temat

Të gjinden bashkërisht përgjigjet

«Unë kam vizituar WSF-në bashkë me fëmijët e mi» tregon Giuseppe Reo, drejtues regional i Unia-s për Zvicrën qendrore. «Për procesin e pjekurisë së tyre ky ishte një përjetim i jashtëzakonshëm. Ata ishin të impresionuar nga përfshirja globale e çështjes së migracionit. Ndërsa unë nga kjo përvojë kam ardhur në përfundim se ne dehet të kujdesemi që të os humbim të arriturat tona. Ne duhet që për problemet e reja të gjejmë përgjigje të përbashkët».

Andrea Tognina
e pëshaturat nga area nr. 12, 26 gusht 2016

Intervistë



Tobias Goldmann

Kryesi e re komisionit për migracion në Unia

Në konferencën e migracionit të Unia-s të datës 28 maj 2016 si kryesues të ri të GI (grupit të interesit) për migracion u zgjodhën Alexandrina Farinha dhe Tobias Goldmann, nga regjioni i Gjenezës, gjegjësisht nga ai Biel-Solothurn-Seeland. Horizonte do tua prezantoj me këtë rast bashkë-kryesuesin Tobias Goldmann.

Thobias na trego shkurt për karrierën tënde.

Unë jam 46 vjeç dhe jam rritur në vendin e bukur të Bayern-it. Pas shkollës për katër vite kam shkuar tek liqeni për të parë diçka nga bota. Për të siguruar stabilitet, mësova zanatin e marangozit. Pastaj vazhdoj më tej me CAD (computer-aided-design / vizatimet kompjuterike-Aidet) dhe punova në startup-software të kësaj fushe. Kam vepruar profesionalisht në Francën jugore, në Zvicrën franceze dhe në Norvegji. Pastaj kreu shkollën për mjeshtrë-marangoz në Gjermaninë veriore dhe vazhdova të drejtoja një zdrukthetari të vogël. Tani 8 vite jam në Zvicrën gjermane dhe punoi përsëri në profesionin tim themelor si marangoz, të cilin e kam edhe pasion.

Si ke ardhur në Zvicër?

Me motoçikletë... Jo, të lëmi shakanë anash: sektori frëngjisht-folës e një firme zhvillimore të CAD (cadwork SA) ka selinë e saj në Montreux. Aty shkova të përmirësoi frëngjishten time.

Ku dhe përse angazhohesh në Unia?

Natyrisht në Olten, ku në ndërkohë edhe kam lëshuar rrënjë. Aty jam në kryesi dhe si i hauj logjikisht edhe në grupin e migracionit. Për këtë ka shumë arsye: e para, sindikatën e shoh si një lëvizje të fuqishme sociale, e cila më jep mundësi e bashkë-formësimit të shoqërisë në të cilën jetoj. E dyta, për mua si njeri i profesionit, punëtorë, zanatli është dhe «klubi» im. Dhe e treta, më krijon kënaqësi, bashkë me koleget e kolegët, të lëvizim gjërat, të diskutojmë dhe të kuptojmë se si me të vërtetë funksionojë gjërat.

Ti tanimë je bashkë-kryesues i komisionit për migracion në Unia. Cili ka qenë interesi yt për këtë funksion?

Nga përvojat e mija në vendet tjera e kuptoj shumë mirë çka domethënë të jesh migrant: të fillosh nga zeroja, të ndërtosh nga e para, të realizosh dëshirën që të pranohet e vlerësojnë të tjerët dhe edhe të tejkaloj kundërshtitë që të bëjnë të tjerët... të të perceptojnë si një njeri ndryshe, si i huaj, si konkurrent. Mirëpo, edhe për të treguar, se – jo së fundi falë Unia – kemi një Zvicër, e cila na e zgjat dorën.

Çka do të arrije me dëshirë në sektorin e migracionit?

Migracioni (çka është e vërteta edhe zanati i marangozit) ekziston që nga koha para Krishtit dhe Nazarethit. Migracioni është emocionues: Unë punojë fjala bie përditë me numra, të cilët siç është e ditur vijnë nga Arabia. Migrantët kujdesen për impulse dhe ide të reja: Kush nuk do të hajë me dëshirë një doner, spageta, apo ushqim tajlandezë...? Unë dua që migracioni të mos pranohet e vlerësohet si kërcënim, porse si fitim.

Ti je i angazhuar edhe si zjarrfikës në Olten. Çka bënë aty?

Përse është kjo me rëndësi për ty?
Unë shërbej si ushtar i thjeshtë për mbrojtje të frymëmarrjes në rast të intervenimeve të të gjitha llojeve. Aktualisht jam i angazhuar edhe në komitetin organizativ të kampionatit zvicëran të zjarrfikësve të rinj. Përse është me rëndësi zjarr fikja, kjo është e qartë. Mirëpo për mua është me rëndësi angazhimi shoqëror, marrja e përgjegjësisë personale për jetën dhe vlerat e bashkëqytetarëve.

7. Cilat janë planet dhe ëndrrat e tua për të ardhmen?

Unë dua ë ne bashkërisht të krijojmë një Zvicër, e cila mund ti shërbejë botës si shembull. Për një shoqëri korrekte, me vetëdije përgjegjësie, të guximshme dhe vizionare, e cila situatën me shumë privilegje nuk e kupton si të drejtë elementare, porse si fat. Personalisht kam qenë skeptik sa i përket natyralizimit, porse nga koha që konfrontohem me këtë temë, kam vendosur që ti hyj edhe vetë kësaj pune.

Marilia Mendes

Tubim tematik me komunitetin shqiptar të regjionit Shafhauzen

EJA DHE ANGAZHOU EDHE TI – PARA SE TË BËHET VONË

Në tubimin me mbi 70 pjesëmarrës kryesisht shqiptaro-zviceran të gjeneratës së dytë, rreth gjysma e tyre me të drejtë vote, bashkëbiseduan për tri orë të plota me politikan të njohur nga regjioni për temat që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen në jetën shoqërore, sindikaliste dhe politike të qytetit, kantonit dhe të Zvicrës si dhe preokupimet tjera, me theks të veçantë: hyrja në fuqi të «ligjit për dëbim» më 1 tetor 2016 dhe atij të «natyralizimit» më 1 janar 2018.

Këtë tubim, të mbajtur më 19 gusht 2016 në sallën e bukur historike «Rathauslaube» të Parlamentit të Qytetit dhe Kantonit Shafhauzen, me pjesëmarrjen e tyre e nderuan Kryetari i Qytetit të Shafhauzenit, Peter Neukomm, drejtuesi i qendrës kantonale dhe i ngarkuari kantonial për çështje integrimi, Kurt Zubler, si dhe Faton Topalli, deputet shqiptaro-zviceran në Parlamentin e Republikës së Kosovës. Ndërsa i ftuari tjetër Walter Vogelsanger, Kryetari i Parlamentit Kantonial mungoi për shkak të një takimi gjithë zviceran në nivel të kryetarëve të parlamenteve kantonale.

Apel dhe informim

Pas përshëndetjes të pjesëmarrësve nga sekretari sindikal të Unia-s në regjionin Cyrih-Shafhauzen, Urim Dakaj, njëherazi kandidat për deputet në Parlamentin kantonial të Shafhauzenit, fjalën e mori sekretari nacional për migracion në sindikatën Unia dhe nënkryetari i migranteve/ëve socialdemokrat të Zvicrës, Osman Osmani. Në vijim po shkëpusim pjesë nga fjala e tij e rastit:

Shqiptarët/et e Shafhauzenit sikur edhe ata/o të tërë Zvicrës kontribuojnë në jetën ekonomike dhe në zhvillimin dhe mirëqenien e gjithmbarshme të qytetit dhe kantonit të tyre. Tanimë në Shafhauzen është duke u rritur edhe gjenerata e tretë shqiptaro-zvicerane.

Është koha që përpos kontributit ekonomik dhe kryerjen e obligimeve të zakonshme qytetare, shqiptaro-zviceranët të zgjerohet edhe me pjesëmarrjen aktive në jetën shoqërore, arsimore, kulturore, politike e të përgjithshme të qytetit, kantonit dhe të gjithë Zvicrës.

Mundësitë, preokupimet dhe sfidat

Një pjesë e mirë e komunitetit tonë në ndërkohë duke marrë shtetësinë janë natyralizuar edhe në Zvicër, ndërsa një pjesë për arsye të ndryshme ende jo. Në ndërkohë ligjet për të huajt janë përqësuar dhe të drejtat e njerëzve pa pasaportë zvicerane janë të pambrojtura. Për shkelje të caktuara edhe të paqëllimita të rregullave dhe ligjeve në fuqi, mund të pasojë dëbimi dhe për ata që tërë jetën e tyre kanë kryer punë shumë të rënda dhe kanë kontribuar ndershmërisht për Zvicrën sikur për vendin e tyre. Të rrezikuar janë edhe gjenerata e dytë dhe e tretë, të cilët janë lindur, rritur e socializuar në Zvicër, por që nuk posedojnë shtetësinë zvicerane. Edhe përkundër refuzimit të iniciativës për «zbatim të iniciativës së dëbimit» në shkurt të këtij viti, megjithatë nga 1 tetori 2016 hynë në fuqi ligji i dëbimit i aprovuar në vitin 2012. Nder të tjera, fjala bie, në katalogun e shkeljeve që mund të qojnë në dëbim, është edhe i ashtuquajturit «keqpërdorim social» i shumë mbi 300.— franga.

Fjalët përshëndetëse kuptimplote

Dy politikanët që mbajnë funksione kyçe në Shafhauzen fillimisht shfaqën kënaqësinë për interesin dhe pjesëmarrjen e të rinjve shqiptaro-zviceran, dhe më pastaj ndër të tjera ftuan të pranishmit të angazhohen me aktivisht në jetën shoqërore e politike të Shafhauzenit, dhe atë pa

Topalli _ mbështeti komunitetin e shqiptarëve edhe në kohërat kur kjo i kushtoi me humbje votash.

Tubimi u përshëndet edhe nga përfaqësuesi i socialistëve të rinj të regjionit (Juso), Stefan Lacher, i cili ndër tjera apeloj tek pjesëmarrësit e rinj që të angazhohen edhe në jetën politike të Shafhauzenit.



Kryetari i qytetit fton të pranishmit për partizipim shoqëror



Informim mbi përkeqësimet ligjore dhe nevojën e natyralizimit

merre parasysh subjektin politik. Ata u zotuan se edhe më tej do të ndjekin politika në të mirë të gjithë banorëve të Zvicrës dhe do të mbështetin natyralizimin e atyre që ende nuk kanë marrë shtetësinë e vendit, me ç'rast fiton edhe të drejta të plota politike sikur edhe vendësit.

Faton Topalli në fjalën e tij potencoi marrëdhëniet e mira shqiptaro-zvicerane, bashkëpunimin mes komunitetit shqiptar dhe socialdemokratëve të Zvicrës ndër vite dhe integrimin e shqiptarëve në Zvicër duke kërkuar nga të pranishmit mbështetjen e kandidatëve të Partisë Socialdemokrate të Zvicrës. Kjo parti – theksoi Faton

Ndërsa edhe Njomëza Gutaj, Kryetare e Pikës së Lëvizjes Vetëvendosje për Cyrih përshëndeti të pranishmit dhe foli për marrëdhëniet e mira mes Socialdemokratëve të Zvicrës dhe Lëvizjes Vetëvendosje.

Pas një pike muzikore folklorike bashkëbisedimi i ngazëlyer vijoj edhe gjatë koktej të rastit me specialitete dhe verë shqiptare të ofruar për të pranishmit nga organizatori – Bashkësia Shqiptare e Shafhauzenit me rrethinë.

Faton Topalli kryetar i BSHS me rrethinë



Pamje nga kokteji me specialitete shqiptare

Ju pyesni, Unia përgjigjet



Masat integruese:

A nuk janë të siguruara të ardhurat?!

Para dy vitesh përfundoi e drejta im për kompensim nga Arka e sigurimit të papunësisë. Më pas përfundova në ndihmën sociale. Pas disa muajsh kërkim pune të pasuksesshme, arrita të gjej një vend të kufizuar pune në një ndërmarrje, e cila udhëhiqet nga një Fondacion. Si masë e ashtuquajtur integruese. E tëra është financuar pjesërisht edhe nga Komuna. Pas këtij punësimi unë u lajmërova përsëri tek Arka e sigurimit të papunësisë. Mirëpo ajo ma komunikoi se kjo kohë pune nuk mund të llogaritet si kohë kontribut-dhënese. Kështu që unë nuk kam të drejtë për kompensim nga Arka e sigurimit të papunësisë. Këtë unë nuk e kuptoi. Nga paga imë janë tërhequr dhe paguar kontributet për sigurimet shoqërore. Koha në të cilën unë kam punuar do të duhej të llogaritej si kohë kontribut-dhënese. Apo jo?!

TIMUR ÖZTÜRK: Jo, jo në çdo rast. Arka e sigurimit të papunësisë nisët nga ajo se, punësimi juaj ka pasur për qëllim integrimin në tregun e punës. Kjo formë e punësimit në të vërtetë nuk llogaritet si kohë kontribut-dhënese. Për Arkën e sigurimit të papunësisë si ardhura të siguruara vlejnë vetëm ato të ardhura, të cilat janë arritur me punësim në tregun e «vërtetë» të punës. Mirëpo jo ato të ardhura që bazohen në masa integruese dhe që vijnë nga entet publike, p.sh. të financuara nga Komuna. Se a janë paguar po jo nga kjo kontributet në sigurimet shoqërore nuk luan ndonjë rol. Këtë praktik e rregullon një Nen i ri në Ligjin për sigurimin në rast papunësie (AVIG: Neni 23, Pika 3...). Ky artikull është aprovuar me rastin e revizionit të fundit të ligjit në fjalë në vitin 2011. Ky Nen përcakton se paga që fitohet nga një person, i cili merr pjesë në një masë integruese pune, e cila financohet pjesërisht apo tërësisht nga entet publike, nuk është siguruar. Jo në secilin rast është e qartë se a ka të bëjë masa për re-integrim në punë m këtë Nen. Përcaktuese është se cili ishte qëllimi i punësimit. Nëse qëllimi kryesor ishte re-integrimi në tregun e punës, atëherë kjo ka të bëjë m Nenin në fjalë. Nëse elementet e punësimit i nënshtrohen një kontrate të zakonshme normale, atëherë puna është ndryshe. Andaj, kërkoni gjithsesi nga Arka e juaj e papunësisë të shqyrtojë e arsyetojë vendimin dhe ju pastaj kontrollojeni me kujdes.

work, 18.08.2016

Shefi i ri:

A duhet të kërkoj një dëshmi pune në ndërkohë?

Unë punoj qe nëntë vite në ndërmarrjen e njëjtë. Tani eprori im i drejtpërdrejtë pensionohet. Me të gjithmonë jemi kuptuar shumë mirë. Një bashkëpunëtor i ri pas disa javësh do të merr përsipër funksionin e drejtorit. Pasi nuk mund ta dijë se çfarë ndryshimesh mund të bij me veti ky ndërrimi i shefit, kam deri diku pasiguri. A duhet të kërkoj një dëshmi ndërkohe pune, deri sa është ende duke drejtuar shefi i vjetër?

ALICE MARIDOR: Po, kjo është një ide e mirë. Kur ndodhin ndryshimi personeli, si rasti në udhëheqje të ndërmarrjes, apo nëse ndërrohet detyrën ose vendin e punës në kuadër të ndërmarrjes, këshillohet të kërkohet lëshimi i dëshmisë ndërkohe të punës. Veçanërisht nëse në ndërmarrjen e juaj nuk lëshohen rregullisht dëshmi ndërkohe të punës.

Ta zëmë, shefi i ri ju ndërroj repartin e punës, apo edhe ju pushon krejtësisht nga puna, ose ju vet doni të jepni dorëheqje për shkak të ndryshimeve, atëherë askujt nuk mund t'ia dëshmoni kualitetin, aftësitë dhe shkathtësitë e juaja të punës. Pastaj problem të veçantë mund të paraqitet me rastin e pakënaqësisë për dëshminë e juaj përfundimtare të punës. Nëse keni një dëshmi ndërkohe të punës, atëherë mund të dëshmoni se si janë vlerësuar kontributi dhe sjellja e juaj gjatë marrëdhënies në punë. Pos kësaj ju keni të drejtë që në çdo kohë të kërkoni një dëshmi pune. Për të evituar keqkuptimet, shpjegojani punëdhënësit tuaj se përse doni të keni një dëshmi ndërkohe pune.

work, 1.07.2016

Impressum: **Beilage zu den Gewerkschaftszeitungen** work, area, Événement syndical | **Herausgeber** work, Gewerkschaft Unia, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano, Chefredaktion: Claudio Carrer | **Redaktionskommission** A. García, A. Rogalewski, D. Filipovic, E. Sariaşlan, M. Martin, M. Mendes, O. Osmani | **Sprachverantwortlich** Osman Osmani | **Layout** I. Schmieler, Unia | **Druck** Tagblatt Print, Im Feld 6, 9015 St. Gallen | **Adresse** Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osman.osmani@unia.ch



Die Gewerkschaft. Le Syndicat. Il Sindacato.

www.unia.ch